




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 295/24
Data. 05.09.24



Prishtinë, 02 prill 2024
Kodi i ZRRE-së: V_1925_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, paragrafi 3 dhe 4, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, dhe Nenit 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084); Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafet 51 dhe 72, Nenit 5, Nenit 33 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1, Nenit 37, Nenit 38 dhe Nenit 62 paragrafi 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085); Nenin 6 par. 1 të Rregullës Nr. 15/2017 për Vendosjen e të Hyrave të Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU); Nenit 17 të Licencës për Furnizim me energji elektrike lëshuar ndërmarrjes "KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY" (KESCO) J.S.C, me numër licence ZRRE/Tr_2014/Li_07/17, e datës 27.04.2017; dhe Vlerësimin e Koncentrimit të Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë përmes Indeksit HHI (Herfindahl–Hirschman Index) për vitin 2023,

në seancën e mbajtur më 02 prill 2024 nxori këtë:

V E N D I M

PËR VENDOSJEN E OBLIGIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK

- I. I VENDOSJET të Licencuarit për Furnizim me Energji Elektrike "KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY" J.S.C (në tekstin në vijim: "KESCO"), Obligimi i Shërbimit Publik për furnizim me energji elektrike konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të Shërbimit Universal.
- II. Obligimi i Shërbimit Publik sipas dispozitivit nën pikën I. të këtij Vendimi, i vendoset për periudhën (2) vjeçare dhe zbatohet nga data **01.04.2024** deri më datën **31.03.2026**.
- III. Të drejtën e Furnizimit si Shërbim Universal e gëzojnë:
 - a. të gjithë konsumatorët familjar;
 - b. Konsumatorët jo-familjar që kanë qarkullim vjetor jo më shumë së dhjetë milion euro (10,000,000 €), ose jo më shumë së pesëdhjetë (50) punonjës;
- IV. Pavarësisht dispozitivin nën pikën III. të këtij Vendimi, të gjithë konsumatorët fundor kanë të drejtë të furnizohen me energji elektrike në tregun konkurrues.
- V. Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejshëm: ZRRE) do të vazhdoj ti rregulloj çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal, të cilat mbulojnë kostot e arsyeshme të furnizimit me energji elektrike.
- VI. Niveli i kostove për furnizim me energji elektrike dhe i çmimeve do të rishikohen në baza vjetore, në pajtim me Rregullën për Vendosjen e të Hyrave të Furnizuesit me Shërbim Universal.
- VII. Furnizuesi i ngarkuar me Obligimin e Shërbimit Publik, sipas këtij Vendimi obligohet që të:
 - a. furnizojë me energji elektrike si shërbim publik sipas kushteve të përcaktuara me këtë Vendim, me licencë, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi,



- b. informojë konsumatorët (blerësit) për të drejtat e tyre dhe kushtet e furnizimit në kuadër të shërbimit universal,
- c. furnizojë me energji elektrike të një cilësie të caktuar sipas Rregullës për Standardet e Cilësisë së Furnizimit dhe Shërbimit,
- d. faturojë energjinë elektrike të livruar në pajtim me çmimet e përcaktuara nga ZRRE, dhe
- e. publikojë tarifën në faqen e vet të internetit, së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të aplikimit.

VIII. Vendimi do të jetë pjesë përbërëse e Licencës për Furnizim me Energji Elektrike të lëshuar “KESCO”-së.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji, bazuar në detyrat dhe funksionet e përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr.05/L_084, në mes tjerash bënë edhe vlerësimin e konkurrencës në tregun me shumicë dhe atë me pakicë të energjisë elektrike në vend.
- Si rezultat i mungesës së konkurrencës efektive dhe me qëllim të sigurisë së furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike si dhe mbrojtjes së konsumatorëve, me datë 27 prill 2017 përmes Vendimit V_916_2017 i ka vendosur KESCO për periudhën 3 vjeçare, nga 01.04.2017 deri 31.03.2020, Obligimin e Shërbimit Publik për ofrimin e Furnizimit me energji elektrike si Shërbim Universal.
- ZRRE përmes Vendimit V_1268_2020 të datës 03 korrik 2020, nga arsyet e njohura të asaj kohe e që lidheshin me Pandeminë COVID19, Obligimi i Shërbimit Publik i është vazhduar edhe për një (1) vit KESCO-së, duke mbuluar periudhën nga 01.04.2020 deri më 31.03.2021. Për këtë veprim është njoftuar edhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.
- ZRRE në mungesë të kuorimit të Bordit të ZRRE-së për të vendosur në lidhje me Obligimin e Shërbimit Universal, përmes komunikimit zyrtar (e-maili i datës 31 mars 2021) ka njoftuar KESCO-në, se Obligimi i Shërbimit Universal i mbetet deri me kompletimin e Bordit të ZRRE-së.
- ZRRE përmes Vendimit V_1419_2021 të datës 07.10.2021, i ka vazhduar KESCO-së, Obligimin e Shërbimit Publik si Furnizues me Shërbim Universal deri me datë 31.03. 2022.
- ZRRE përmes Vendimit V_1501_2022 të datës 31.03.2022 i ka vazhduar KESCO-së, Obligimin e Shërbimit Publik si Furnizues me Shërbim Universal edhe për një (1) vit, duke filluar nga data 01.04. 2022 deri më 31.03.2023.
- ZRRE bazuar në Vlerësimin e koncentrimin të tregut të energjisë elektrike në Kosovë përmes indeksit HHI (Herfindahl–Hirschman Index) për vitin 2022, përmes Vendimit V_1684_2023 të datës 23 mars 2023, i ka vendosur KESCO-së, Obligimin e Shërbimit Publik për ofrimin e Furnizimit me energji elektrike si Shërbim Universal, për periudhën një (1) vjeçare, nga 01.04.2023 deri 31.03.2024.
- ZRRE vlerëson se vendosja e Obligimit të Shërbimit Publik, bazohet në vlerësimin e koncentrimin të tregut të energjisë elektrike në Kosovë përmes indeksit HHI (Herfindahl–Hirschman Index) për vitin 2023, vlerësim i cili mbështetet në llogaritjen e indekseve të



përqendrimit të tregut, të tilla si përqindja e tregut (MS), raporti i përqendrimit (CRn), Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI), Treguesi i Furnizuesit Kryesor (PSI) dhe Indeksi i Furnizimit Rezidual (RSI), dhe ky vlerësim paraqet se tregu i energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë ende vazhdon të ballafaqohet me mungesë konkurrence dhe përqendrim të lartë.

- Nga rezultatet e përfituara nga Indeksi për Matjen e Përqendrimit të Tregut (HHI), rrjedh se për tregun e energjisë elektrike me shumicë indeksi HHI ka vlerën 7,634, kurse për tregun e energjisë elektrike me pakicë ka vlerën 9,834, me ç'rast, bazuar në standardet e HHI, është konstatuar se edhe për vitin 2023 përqendrimi në tregun e energjisë me shumicë dhe me pakicë është shumë i lartë, që nënkupton se tregu i energjisë elektrike në vend edhe në këtë vit ballafaqohet me mungesë të konkurrencës.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të rezultateve të vlerësimit të koncentrimit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë përmes indeksit HHI, duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, si dhe aftësitë operative të KESCO-së, për të ofruar Furnizimin me Energji Elektrike si Shërbim Universal, i ka vendosur KESCO-së, Obligimin e Shërbimit Publik për ofrimin e Furnizimit me Energji Elektrike si Shërbim Universal, për periudhën e përcaktuar si në dispozitiv të këtij Vendimi.

IX. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


X. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së:




Ymer Fejzullahu, Kryesues




Lutfije Dervishi, Anëtare



Gani Buçaj, Anëtar



Arta Isufi, Anëtare



Adrian Preniqi, Anëtar

Vendimi i dërgohet:

KESCO,
KEDS,
KOSTT-it dhe
Aktivit të ZRRE-së.